



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:153081
Datë: 08.03.2023
Numri i dokumentit: 04057210

KML.nr.1/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.V., nga F., për shkak të kundërvajtjes nga neni 36, par.3 pika (a) të Ligjit për Pyjet e Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Kryeprokurorit të Shtetit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ka.nr.346/2022, të datës 05.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 10.02.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të Kryeprokurorit të Shtetit, anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ka.nr.346/2022, i datës 05.10.2022 dhe çështja penale i kthehet Gjykatës së Apelit të Kosovës në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes, me aktgjykimin K.nr.1156/21 të datës 14.07.2022 të pandehurin M.V., e ka shpallur përgjegjës për shkak të kundërvajtjes nga neni 36, par.3 pika (a) të Ligjit për Pyjet e Kosovës dhe i ka shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e në rast të mos pagesës në afatin ligjor i njëjti dënim do të ekzekutohet me dhunë sipas dispozitave të

ligjit për procedurën përbarimore. I pandehuri është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 5 €. Në pajtim me nenin 37 dhe nenit 38 të LK-së , të pandehurit i merren drutë pa kompensim sipas procesverbalit të datës 09.12.2020.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin Ka.nr.346/2022 e datës 05.10.2022, e ka hudhur poshtë si të pas afatëshme ankesën e paraqitur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- APK.

Kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar Kryeprokurori i Shtetit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par.2 të KPPK, me propozim Gjykata Supreme e Kosovës, të aprovon si të bazuar kërkesën, ndërsa aktvendimin e kundërshtuar t'a anulon dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës së Apelit.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Kryeprokurorit të Shtetit theksohet se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-APK, Kryeprokurori i Shtetit ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë gabimisht e ka llogaritur afatin për paraqitjen e ankesës nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-APK duke e marrë si datë të dorëzimit të ankesës datën 12.08.2022. Më tej theksohet se nga shkresat e lëndës nga fletëpranimi i aktgjykimit të shkallës së parë rezulton se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit Rural-APK, aktgjykimin e shkallës së parë e ka pranuar me datën 03.08.2022, ndërsa nga fletë dorëzimi i ankesës në postën e Kosovës vërtetohet fakti që ankesën APK e ka ushtruar me datën 09.08.2022, e që rezulton se ankesa është dorëzuar brenda afatit ligjor prej 8 ditësh. Pasi që me llogaritjen e gabuar të afatit, aktvendimi i shkallës së dytë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 nën par. 2.1 të KPPK.

Duke e shqyrtuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se pretendimet e paraqitura në kërkesë janë të bazuara. Kjo për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par.2 nën par. 2.1 të KPPK.

Duke e analizuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së dytë, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se Gjykata e Apelit të Kosovës, gabimisht e ka llogaritur afatin e paraqitjes së ankesës nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-APK, duke e llogaritur se ankesa është paraqitur me datën 12.08.2022, kundër aktgjykimit të shkallës së parë, me që rast ka konsideruar se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor prej 8 dite.

Nga shkresat e lëndës e bazuar në fletë pranimin e aktgjykimit të shkallës së parë rezulton se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, aktgjykimin e shkallës së parë e ka pranuar me datën 03.08.2022, ndërsa ankesën e ka ushtruar me datën 09.08.2022, që vërtetohet përmes shkresës së dorëzimit të ankesës në Postën e Kosovës me nr. të pranimin 2212362 dhe ref: DQIPGJ 290/22.

Kështu që, në rastin konkret, pasi që aktgjykimi është pranuar me datën 03.08.2022, ndërsa ankesa është ushtruar me datën 09.08.2022, do të thotë se ankesa është paraqitur brenda afatit të rregullt ligjor prej 8 ditësh. Nga këto arsye u vendos që kërkesa të aprovohet dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit K.a.nr.346/2022 i datës 05.10.2022, të anulohet.

Andaj, sipas Vlerësimit të kësaj Gjykate, Aktvendimi i shkallës së dytë është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nën par.2.1 të KPPK,

Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së dytë duhet ketë në konsideratë evitimin e vërejtjeve të lartcekura, duke i ndërmarr veprimet përkatëse procedurale, ndërsa më pastaj të marrë një vendim, cili duhet të përpilohet dhe arsyetohet në mënyrën e parashikuar me ligj.

Duke u bazuar në këto që u theksuan më lart dhe në pajtim me nenin 438, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.2. të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
KML.nr.1/2023, më datë 10.02.2023

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka